

ANALIZA VJETORE 2022, PËR DEPARTAMENTIN JURIDIK DHE DREJTORINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Më datën 10 Shkurt 2023, në mjediset e KLSH-së u zhvillua analiza vjetore për punën e kryer gjatë vitit 2022 të Departamentit Juridik dhe Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.

Aktiviteti u hap nga z. Gjovalin Preçi në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, i cili në fjalën e tij përshëndeti dhe falenderojë përfaqësuesit e Departamentit/Drejtorisë përkatëse për punën dhe bashkëpunimin.

Kryeaudituesi i Departamentit Juridik, z. Koço Sokoli paraqiti raportin mbi veprimtarinë e Departamentit Juridik, në fokus të së cilës ka qenë dhënia e asistencës juridike për KLSH gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij institucionale si dhe prezantoi përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të KLSH, në proceset gjyqësore penale, administrative apo civile ku ky i fundit ka qenë palë ndërgjyqëse dhe/ose person i tretë.

Gjithashtu në fjalën e tij, z. Sokoli referoi mbi angazhimin e KLSH-së në luftën kundër korrupsionit, e cila ka përparësi përse i përket efektivitetit në luftën kundër korrupsionit, kjo për shkak të aftësisë dhe mundësisë së zbulimit të rasteve të korrupsionit dhe parregullsive, evidentimit të pikave të dobëta të sistemit nëpërmjet të cilave korrupsioni arrin të depërtojë dhe zhvillohet. Për rrjedhojë KLSH tashmë përfshihet si partner i rëndësishëm në çdo strategji kundër korrupsionit.



Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm Z. Sinamataj theksoi se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm luan një rol të rëndësishëm dhe me impakt të vecantë pasi kontribuon dhe ndihmon KLSH-në për të arritur objektivat, duke përmirësuar efektshmërinë e menaxhimit të riskut, identifikimit të dobësive të sistemit menaxherial, evidentimin e problematikave të ndryshme dhe dhënien e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e punës. Gjatë vitit 2022 është vazhduar me përfshirjen në projektet e auditimit të departamenteve/drejtorive ose sektorëve të cilët nuk janë audituar ende me qëllim mbulimin me auditim të të gjithë institucionit për një periudhë 3(tre) vjecare.

Për vitin 2022 u planifikuan 6 programe auditimi me bazë sistemi. Llogaritja për numrin e planifikimit të programeve të auditimit është bërë duke patur parasysh strukturën me burimet njerëzore të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm. Periudha raportuese korrespondon me periudhën nga muaji janar deri në muajin dhjetor 2022. Plani i Auditimeve është realizuar në masën 100 %. Nga ana e strukturave të audituara dhe niveli menaxherial janë pranuar plotësisht 15 (pesëmbëdhjetë) rekomandime si dhe është përgatitur dhe dërguar në kohë Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, për secilin nga auditimet e kryera.

Analiza vjetore, përfundoi me fjalën përmbyllëse të z. Gjovalin Preçi.